



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 15

Prishtinë, më 14.05.2015, në orën 09:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-II

PROCESVERBAL

I Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në mbledhje morën pjesë: Lirije Kajtazi, kryetare, Salihe Mustafa, Mexhide Mjaku-Topalli, Mytaher Haskuka, Teuta Haxhiu, Valdete Bajrami, Etem Arifi dhe Kujtim Paçaku.

Munguan: Kujtim Paçaku dhe Slavko Simiq.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Reshit Gashi, koordinator i Komisionit, Sulltane Gashi, zyrtare e fushës dhe Burim Tahiri, mbështetës i Komisionit, UNICEF.

I ftuar: Sami Kurteshi- Avokat i Popullit.

Pjesëmarrës të tjerë: Visar Bivolaku, EU/EUSR; Edona Tolaj-YIHR KS; Lejla Selimi-OSBE; Selda Miftari, SSCE; Labinot Sheremeti, Tafil Rrahmani, Irfan Kastrati, Basri Berisha, Isa Hasani, IAP; Arta Xhyllani- praktikante në Kuvendin e Kosovës.

Mbledhjen e kryesoi në fillim, Salihe Mustafa, zëvendëskryetare e parë e Komisionit, e pastaj kryetarja e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2014. (I ftuar për këtë pikë të rendit të ditës është Avokati i Popullit, z. Sami Kurteshi).

Kryesuesja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

Salihe Mustafa, zëvendëskryetare e parë e Komisionit, filloi mbledhjen e Komisionit dhe tha se Raporti vjetor i Avokatit të Popullit, është i hartuar mirë dhe e përmbushë formën për shqyrtim. Raportin para Komisionit do ta prezantojë Avokati i Popullit, z. Sami Kurteshi.

Sami Kurteshi, falënderoi anëtarët e Komisionit dhe prezantoi ekipin përfaqësues të Avokatit të Popullit. Më pas, tha se raporti është i ndarë në pesë pjesë. Pjesa e parë përmban pjesën ekzekutive, me kapitujt ndarës me përgjegjësi dhe kompetenca të veçanta. Në raport kanë punuar një grup prej 35 personave, ndërsa secili ka punën e vet dhe detyrat përcaktuese. Por, raporti në përfundim, është i krijuar nga një person dhe jo 35 persona. Është në gjuhën shqipe, angleze dhe serbe, si burime primare marrim rastet në institucion, por edhe të dhënat nga institucioni që merren si burime, ku janë 2224 dëshmi që kanë ardhur si raste në zyrat e Avokatit të Popullit e që janë të përfshirë disa prej tyre në raport, sepse 75% e tyre janë të papranueshme, për arsye se njerëzit nuk i njohin kompetencat e Avokatit të Popullit. Po ashtu, shumë raste janë në procedura ligjore e që nuk hyjnë në raste të dyfishta, andaj vetëm 587 janë hapur për hetime, ndërsa priten e ankuesve e bëjnë 2 herë në javë. Në kuadër të këtij raporti, janë nxjerrë 141 rekomandime për institucione të ndryshme.

Kryetarja, nga puna që është bërë tek raporti kërkon që edhe deputetët të pyesin apo komentojnë për raportin.

Teuta Haxhiu, falënderoi Institucionin e Avokatit të Popullit për punën që kanë bërë në lidhje me raportin. Po ashtu, tha se ka lexuar komplet raportin dhe ajo që ka vërejtur është numri shumë i madh i ankuesve, e që sipas saj, është një anë pozitive, pasi që janë vetëdijësuar qytetarët, por ana negative është numri i madh i ankesave të refuzuara nga ky institucion, pasi që nuk kanë qenë në kompetencën e tyre. Gjithashtu, u vërejt se ankesat më së shumti kanë pasur të bëjnë me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, përkatësisht me Departamentin e Skemave Pensionale, që edhe deputetët ballafaqohen me këto probleme të këtyre skemave. Ajo që vlen të vlerësohet dhe përmendët është se pas çdo institucioni, pas secilës pjesë të veçantë, janë dhënë rekomandimet dhe uron që institucionet relevante të merren seriozisht me këto rekomandime.

Ajo theksoi se me Ligjin për barazi gjinore dhe për mbrojtjen nga diskriminimi, si institucion, i shtohen kompetencat, dhe në kuadër të buxhetit, tash me këto kompetenca shtesë, kërkohet edhe buxhet shtesë. Është një raport që duhet shikuar dhe vlerësuar, sepse rastet që duhet të dërgohen në gjykatë, janë drejtuar tek ju, ndoshta për mjete jo-materiale për pagesë të avokatit nga qytetarët.

Sami Kurteshi, tha se kanë 3 kompetenca shtesë: mekanizmit kombëtar kundër torturës, që kanë punuar me dy organizata të shoqërisë civile, sepse do të ketë për burime shtesë, pastaj ligji kundër diskriminimit, edhe këtu nevoja për ekspert, si dhe Ligji për barazi gjinore. Duke mos krijuar institucione të veçanta, mirëpo si institucion, të shfrytëzohen të gjitha kompetencat dhe të punohet e mos të kalojë koha.

Mytaher Haskuka, tha se është një raport i mirë. Po ashtu, dëshiron të dijë se cilat janë ato institucione që nuk përgjigjen në rekomandimet e Institucionit të Avokatit të Popullit, sepse vetëm 18% prej tyre, janë të implementuara, ndërsa 46% prej tyre të pa-implementuara. Pyeti: - A ka ndonjë analizë se cilat institucione iu përgjigjen rekomandimeve apo si paraqitet kjo?

Sami Kurteshi, janë të precizuara në faqen 194 të gjitha dhe kanë bërë përpjekje të paraqesin vetëm rekomandime të raporteve të veçanta dhe nga raporte të përgjithshme, duke u bazuar në metodën e Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut në OKB. Edhe pse mund të ketë ndonjë gabim tek këto rekomandime. Si shembull konkret merr një rekomandim, siç ka qenë rasti për nxjerrjen e një vendimi për regjistrim me automatizëm për fëmijët e kategorive të dala nga lufta, që si rekomandim kërkojnë të shfuqizohet ky vendim, pra si rast konkret dhe i veçantë.

Valdete Bajrami, tha se shumë qytetarë nuk e dinë se cilat janë kompetencat e Avokatit të Popullit. A ka pasur ndonjë institucion, qoftë i pavarur apo shtetëror që ka mbajtur ndonjë tryezë, dëgjim nëpër komuna apo në qendër, për t'i njoftuar apo treguar se kur mund dhe për cilat arsye të drejtohen qytetarët tek Avokatit i Popullit, në mënyrë që të mos ngarkohet Avokati i Popullit me të gjitha, sepse dihet sistemi i drejtësisë dhe besueshmëria ndaj tyre që është nën nivel, andaj mund të thuhet që edhe jeni shtylla e pavarur e tyre për t'u ankuar.

Sami Kurteshi, tha se kanë pasur fushata për sensibilizim kohë pas kohë nga partnerët ndërkombëtarë në formë të pllakateve apo në media. Një fushatë tjetër ka qenë ajo me Lëvizjen FOL nëpër të gjitha komunat e vendit. Edhe tani, si institucion, në fund të javës, do të organizojnë një fushatë në komunat e Kosovës. Ndërsa, sa i përket pritjes së ankuesëve, nuk kalon dy ditë nga marrja e përgjigjes, se a janë kompetentë apo jo. Zonat rurale janë ato që janë më problem për të marrë informata nga ankuesit, por do të punohet në këtë drejtim.

Mexhide Mjaku-Topalli, tha se raportin e kanë marrë me vonesë. Njëra nga çështjet më kryesore dhe më kompetente në Raportin e Progresit, por edhe në rrugën për në Evropë, është respektimi i të drejtave të njeriut, ka marrë disa mesazhe dhe porosi nga rekomandimet që do ta keni mbështetjen tonë, sidomos tek rekomandimet të ndikimi i ndotjes së mjedisit në shëndetin e njeriut, barazi para ligjit, e drejta për arsim, liria e lëvizjes, ndërsa sa i përket lirisë së mediave, nuk kishte pasur asnjë ankesë që më bëri përshtypje, pasi liria e shprehjes është një mundësi e mirë për të pasur mesazhe drejtpërdrejt nga qytetarët.

Sami Kurteshi, tha se kanë realizuar takime te veçanta me gazetarët, mirëpo nuk e dinë se pse nuk kanë sjellë asnjëherë ndonjë ankesë dhe nuk iu kanë thënë asnjë arsye, edhe pse dalin të ankohen, por nuk shkojnë tek Avokati i Popullit, sepse dihet që mediat janë pushteti i katërt. Anketën që kanë bërë me gazetarë, vetëm 1% prej tyre janë përgjigjur.

Salihe Mustafa, tha se nga rastet e shumta që keni e nuk janë në kompetencën e Institucionit të Avokatit të Popullit, nuk ka mjaft fushata sensibilizuese. Atëherë, kush duhet t'i realizojë këto fushata? Ka edhe raste të shumta që janë për ju e që nuk dinë ku të paraqiten, andaj nuk ka buxhet apo resurse njerëzore që së paku në media të njoftohet që qytetarët duhet të paraqiten tek Avokati i Popullit apo mendohet që dikush tjetër është kompetent për këto fushata.

Sami Kurteshi, niveli i rasteve të papranueshme nga Avokati i Popullit është më i mirë, në krahasim me disa vende të Evropës, që atje janë edhe më të informuar për Avokatin e Popullit, andaj nuk do të duhej të shqetësohemi aq shumë. Përveç mjeteve të brendshme, duhet edhe mjetet e jashtme të shfrytëzohen nga institucionet për Avokatin e Popullit. Si paraqitje promovuese kanë pasur një prezantim prej 12 serive në njërin nga televizionet. Si njëri ndër obligimet e Institucionit të Avokatit të Popullit është promovimi i të drejtave të njeriut.

Salihe Mustafa, tregoi se si Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka arritur të shfaqet dhe të kuptohet ekzistenca e saj aq shpejt në Kosovë, përmes mediave, për të gjithë qytetarët.

Mexhide Mjaku-Topalli, potencoi një rekomandim që thotë se është i domosdoshëm një sensibilizim dhe fushatë informuese, e që kjo kujt i adresohet.

Sami Kurteshi, tha se kjo i drejtohet edhe vetë Institucionit të Avokatit të Popullit.

Kryetarja, duke pasur mbështetjen e Komisionit dhe dëshirën për bashkëpunim, në mënyrë që të rritet rëndësia dhe niveli i këtij institucioni, dhe pa ndikime politike, të punohet për qytetarët. Po ashtu, falënderoi këtë institucion për punën e bërë, duke shpresuar në zgjedhjen sa më të shpejtë të Avokatit të Popullit.

Sami Kurteshi, e gjithë puna që është shkruar në raport, është treguar ajo që është pa ndryshime dhe pa ndërhyrje politike.

Kryetarja konstatoi se pas shqyrtimit të Raportit vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2014, Komisioni, unanimisht, nxori këtë

Rekomandim

Komisioni e miratoi Raportin vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2014 dhe e procedon për shqyrtim në Kuvend.

Kryetarja, njoftoi anëtarët e Komisionit se ka ardhur një shkresë nga kryeministri i Kosovës, i cili ia ka dërguar kryeparlamentarit, që thuhet se duhet të kalojnë disa ligje në procedurë të përshpejtuar, e ndër to janë edhe projektligjet, për Avokatin e Popullit, për barazi gjinore dhe mbrojtjen nga diskriminimi.

Sa i përket ndarjes së grupeve punuese, në qoftë se mungon Slavko Simiq tek Projektligji për mbrojtjen nga diskriminimi, propozoi të bashkëngjitet Mexhide Mjaku-Topalli.

Mbledhja përfundoi në orën 10:00.

E përgatiti: Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit

Lirije Kajtazi